



4 European
Union
Kosovo

Dilema 10%

përfitimet dhe dëmet nga
tërheqja e parakohshme e
kursimeve pensionale



Korrik 2020

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

Dilema 10%
përfitimet dhe dëmet nga
tërheqja e parakohshme e
kursimeve pensionale

—
Korrik 2020

— **Përmbajtja**

3 Përmbledhje ekzekutive

4 Hyrje

5 Përparësitë e tërheqjes së
hershme të kursimeve pensionale
nga Trusti



7 Dëmet nga tërheqja e hershme e
kursimeve pensionale nga Trusti

9 Përfundime

Përmbledhje ekzekutive

Për t'i zvogëluar pasojat socio-ekonomike të pandemisë, Qeveria Kurti e aprovoi Pакon Fiskale Emergjente e cila përmbante 15 masa për intervenim të menjëhershëm financiar në situatën e krijuar.¹ Në muajt pasues, në një seri të hulumtimeve, Instituti GAP analizoi ndikimin e pakos emergjente në lehtësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës,² me fokus në adresimin e papunësisë³ dhe rënien e investimeve kapitale.⁴ Pak kohë më pas, Qeveria Hoti prezantoi programin për rimëkëmbje ekonomike pas pandemisë, i cili synon të ofrojë mbështetje për sektorin privat dhe kompensim për humbje të shkaktuara nga pandemia. Mirëpo, pjesa e këtij programi që tërhoqi më së shumti vëmendje nga qytetarët është ajo për rritje të kërkesës agregate, që praktikisht do tu mundëson atyre tërheqjen e parakohshme të një pjese të kontributeve të tyre nga Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (Trust-i).

Një masë e tillë, edhe pse e përkohshme, përveç se kërkon ndryshime ligjore nga ana e Kuvendit të Kosovës, kërkon një analizë më të thuktë të përfitimeve të menjëhershme dhe dëmeve afatgjate. Prandaj në këtë analizë, Instituti GAP do të fokusohet në ndikimin potencial të kësaj politike tek qytetarët dhe ekonominë e vendit. Më konkretisht, do të ofrohet një analizë kualitative mbi përparësitë dhe dobësitë e një politike të tillë. Mirëpo, meqenëse qasja në të dhëna aktuale nga Trust-i nuk iu është mundësuar Institutit GAP, ende mbetet i nevojshëm një hulumtim kuantitativ mbi dallimet potenciale të politikës së “10%-shit” në bazë të kategorive të ndryshme të kontributpaguesve në Trust.



- 1 Vendimi i Qeverisë së Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3bCWLr4>
- 2 Instituti GAP, “Ndikimi i pandemisë COVID-19 në pushtetin lokal”, <https://bit.ly/3owcjQm>
- 3 Insituti GAP, “Ndikimi i pandemisë COVID-19 në tregun e punës”, <https://bit.ly/3eRbmRg>
- 4 Instituti GAP, “Ndikimi i pandemisë në buxhetin e Kosovës”, <https://bit.ly/39iinJD>

Hyrje

Që nga fillimi i pandemisë së virusit korona, Kosova kufizoi lëvizjen e qytetarëve të tyre dhe urdhëroi mbylljen e shumë aktiviteteve ekonomike. Meqenëse masat parandaluese ndikuan që numri i të infektuarëve të mbahet relativisht i ulët në fillim, Qeveria e Kosovës urdhëroi më pas që shteti të kalojë nëpër tri faza lehtësuese ku masat do të largoheshin gradualisht. Mirëpo, mbyllja e shumicës së veprimtarive ekonomike përveç atyre esenciale, edhe pse jo për një kohë të gjatë shkaktoi rënie të menjëhershme të të hyrave të shumë bizneseve.⁵ Në fakt, sipas raportit më të fundit të Bankës Botërore mbi Ballkanin Perëndimor, parashihet që ekonomia e Kosovës, gjatë vitit 2020 në tërësi të bie për 4.5% si pasojë e mbylljes së ekonomisë, ku prej tyre rënien më të lartë do ta kenë investimet (-21.5%) dhe eksportet (-12.2%).⁶

Për t'i adresuar këto sfida, më 22 qershor 2020, Kryeministri Hoti prezantoi programin për rimëkëmbje ekonomike me vlerë prej 1.2 miliardë euro, i cili ka për qëllim zhvillimin ekonomik afatgjatë pas pandemisë, ndërtimin e politikave nxitëse për sektorin privat dhe kompensimin për humbjet ekonomike të shkaktuara si pasojë e pandemisë. Ky program përmban disa masa lehtësuese në të bërit biznes, sikurse masa për lehtësim të qasjes në financim, masa për zvogëlim të barrës tatimore, dhe masa për mbështetje të punësimit, bujqësisë dhe kërkesës agregate.⁷

Një ndër masat e këtij programi, e cila ka tërheqë më së shumti vëmendje nga qytetarët, është ajo për stimulim të kërkesës agregate. Ajo masë parashihet të zbatohet duke ua mundësuar qytetarëve të tërheqin në mënyrë të parakohshme deri në 10% të mjeteve të kursyera në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trust).⁸ Fillimisht, sipas programit qeverisës, fondet e tërhequra ishin paraparë që të kompensoheshin nga Qeveria e Kosovës brenda pesë viteve. Mirëpo, më 6 korrik 2020, Qeveria bëri të ditur se ka vendosur kundër kompensimit të mjeteve të tërhequra.⁹ Megjithatë, përveç faktit që procesi i tërheqjes është ende i paqartë, për realizimin e kësaj mase duhet të plotësohet Ligji Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës me Ligjin Nr. 04/L-115, me Ligjin 04/L-168 dhe Ligjin Nr. 05/L-116.¹⁰

Neni 12 i Ligjit Nr. 04/L-101 përcakton që kur kontribuuesi arrinë moshën e pensionimit (65 vjeç), ajo apo ai do të bën blerjen e kursimeve pensionale.¹¹ Megjithatë, plotësimi i këtij ligji si pjesë e pakos për rimëkëmbje shton Nenin 12A me 6 pika, ku ndër tjera përcaktohet se kontribuuesi mund t'i tërheq 10 përqind të kursimeve pensionale me rastin e krizës ekonomike të shkaktuar nga pandemia, dhe fondet e tërhequra do të jenë të përjashtuara nga tatimi në të ardhurat personale.¹² Kontributet pensionale sigurojnë jetesën e qytetarëve për një kohë të caktuar pas pensionimit, andaj tërheqja e parakohshme e një pjese të atyre fondeve pa dyshim së do të ketë ndikim në planet afatgjatë pensionale të qytetarëve. Edhe pse ekziston edhe alternativa e fondit Sllaveno-Kosovar për siguri pensionale, projektligji për rimëkëmbje ekonomike nuk përmbanë ndonjë nen që ka ndikim në të.

5 “Anketë mbi ndikimin e COVID-19 në ndërmarrjet në Kosovë,” Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, Prill, 2020. Burimi: <https://bit.ly/2C5kEhA>

6 “Western Balkans Regular Economic Report: Spring 2020,” Banka Botërore. Burimi: <https://bit.ly/3oeZLq3>

7 “Kryeministri Hoti: Kemi program të detajuar për rimëkëmbjen ekonomike,” Zyra e Kryeministrit, 22 Qershor, 2020. Burimi: <https://bit.ly/32lnx6y>

8 Programi Qeverisës 2020-2023. Burimi: <https://bit.ly/2CBIXTb>

9 “Sqarim,” Ministria e Financave e Kosovës, 06 Korrik, 2020. Burimi: <https://bit.ly/3jePC5s>

10 “PROJEKTILIGJ PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE - COVID-19,” Zyra e Kryeministrit, 15 Korrik, 2020. Burimi: <https://bit.ly/39beGWe>

11 “LIGJI NR. 04/L-101 PËR FONDET PENSIONALE TË KOSOVËS,” Zyra e Kryeministrit, 08 Maj, 2012. Burimi: <https://bit.ly/3ov8Mvj>

12 “PROJEKTILIGJ PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE - COVID-19,” Zyra e Kryeministrit, 15 Korrik, 2020. Burimi: <https://bit.ly/39beGËe>

Për shkak se tërheqja e parakohshme e mjeteve nga Trust-i është ngjarje e paprecedent, si qytetarët ashtu edhe institucionet bartëse do të ballafaqohen me një situatë pjesërisht të panjohur. A do ta rriste konsumin e brendshëm tërheqja e parakohshme e kursimeve pensionale? A do të ndihmojë kjo politikë në lehtësimin e barrës së borxheve të qytetarëve dhe në rritjen e të hyrave të buxhetit të Kosovës? A ekziston mundësia që fondet e tërhequra të shpenzohen në produkte të importuara apo edhe jashtë shtetit, gjë që nuk do ta ndihmonte ekonominë e Kosovës detyrimisht? Dhe mbi të gjitha a po krijon qeveria një praktikë të ndërhyrjes së parakohshme në kontribute pensionale që do të përdoret edhe nga qeveritë tjera në raste të situatave të rënda ekonomike? Këto janë disa prej pyetjeve që synon t'i analizojë ky raport i shkurtër i Institutit GAP.

Përparësitë e tërheqjes së hershme të kursimeve pensionale nga Trusti

Në rast se Kuvendi i Kosovës miraton ndryshimet ligjore që të lejohet tërheqja e parakohshme e kursimeve pensionale deri në 10%, kjo nuk do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në buxhetin e shtetit apo në borxhin publik të Kosovës. Meqë këto të holla nuk do të kompenzohen nga buxheti i shtetit, ato nuk do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në buxhet apo në borxhin publik.¹³

Personat me të ardhura më të larta dhe me përvojë pune më të gjatë kanë më shumë para të kursyera, rrjedhimisht këta persona do të kishin mundësinë që të tërheqin shuma më të mëdha parash. Kjo do t'i mundësonte Qeverisë së Kosovës që paratë për stimulimin e ekonomisë, të planifikuara në "Pakon e Rimëkëmbjes", t'i orientojë më shumë tek personat që nuk kanë mundur të përfitojnë nga kjo masë, sikurse që janë qytetarët e papunë, punëtorët pa kontrata pune, dhe personat që kanë kursime të pamjaftueshme në Trust. Megjithatë, deri më tani në pakon e propozuar, kjo përparësi nuk duket se është shfrytëzuar.¹⁴

Tërheqja e të hollave nga Trusti është paraparë të bëhet në mënyrë vullnetare. Qytetarët të cilët nuk duan t'i tërheqin kursimet pensionale, nuk janë të obliguar ta bëjnë një gjë të tillë.¹⁵ Në anën tjetër, kjo masë mundëson qasje të hershme në këto kursime për qytetarët të cilët kanë nevojë për këto fonde. Gjatë tërheqjes, kontributpaguesit janë të liruar nga tatimi në të ardhura dhe nga çfarëdo pagese ndëshkuese për tërheqje të fondeve në mënyrë të parakohshme siç është rasti me fondet pensionale private dhe në kompani të sigurimeve.¹⁶

Përveç kontributit, i cili është i obliguar me ligj, ekziston mundësia e punëdhënësve dhe punëmarrësve që në një të ardhme, në mënyrë vullnetare, t'i rikuperonin paratë e tërhequra në Trusti duke e rritur kontributin deri në 10% të pagës së tyre vjetore.¹⁷ Në anën tjetër, mbetet mundësia që qytetarët të investojnë/kursejnë edhe në fonde të tjera private, kompani të sigurimeve apo institucione financiare që ofrojnë pensione individuale.¹⁸ Moshë mesatare e kontributpaguesve në Trust është relativisht e re, me rreth 41 vjeç që lejon rikuperimin e parave të tërhequra para se të arrihet moshë e pensionit.¹⁹

13 Ministria e Financave. Burimi: <https://bit.ly/2Ow8WNk>

14 Masat e Pakos së Rimëkëmbjes të përmbjedhura nga Instituti GAP. Burimi: <https://bit.ly/3fNNcsf>

15 Ibid.

16 Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike - Covid-19. Burimi: <https://bit.ly/2OlfV6o>

17 Banka Qendrore e Kosovës. Rregullore. Neni 6, pika c. Burimi: <https://bit.ly/3hhJKGD>

18 Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës. Neni 21 Format e pensioneve plotësuese individuale. Burimi: <https://bit.ly/2CmuiKN>

19 Trusti. Raporti vjetor 2019. Burimi: <https://bit.ly/2ZwjUsE>

Tërheqja eventuale e një pjese të fondeve të Trustit nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe bankat komerciale nuk do ta rrezikonte likuiditetin e sistemit financiar të Kosovës. Deri më datën 13 korrik 2020, Trusti mban mbi 196.6 milionë euro në bankat komerciale në Kosovë, rreth 32.5 milionë në BQK dhe rreth 1.8 miliardë euro në instrumente tjera financiare.²⁰ Tërheqja eventuale e të gjitha mjeteve të Trustit nga Banka Qendrore dhe depozitat afatshkurta të bankave komerciale për t'i mbuluar pagesat e qytetarëve që vendosin t'i tërheqin 10% të fondeve të kursyera, nuk do të shkaktonte krizë të likuiditetit të bankat komerciale në Kosovë. Paratë e Trustit në BQK përbëjnë më pak se 11 përqind të parave të gatshme, ndërsa nga 196.6 milionë euro depozita bankare, rreth 75 milionë prej tyre janë depozita afatshkurta (më pak se një vit).²¹ Varësisht nga shuma e tërhequr, këto dy mënyra mund të mbulojnë një pjesë të madhe të tërheqjes së kursimeve.

Me tërheqjen e kursimeve të parakohshme nuk pritet të rrezikohet as likuiditeti i vetë Trustit. Deri në muajin qershor 2020, ky institucion kishte rreth 20.4 përqind të fondeve të investuara në instrumente financiare mjaft likuide të cilat mund të shndërrohen shumë lehtë dhe shpejt në para të gatshme për t'i mbuluar pagesat.²² Në rast të nevojës, Trusti mund edhe të shesë instrumente financiare si ato të borxhit apo akcione të ndryshme për të përballuar tërheqjen e 10%-shit. Për më tepër, edhe pas tërheqjes eventuale të 10%-shit, Trusti vazhdon të mbetet likuid dhe rrjedhimisht gëzon mundësinë e alokimit të mjeteve edhe në instrumente të borxhit të shtetit apo në instrumente tjera financiare. Megjithatë, rialokimi i fondeve mbetet kompetencë e menaxhmentit të fondit të Trustit i cili bën investimet bazuar në interesin e kontributpaguesve duke respektuar rregulloret dhe ligjet në fuqi.

Deri më datën 13 korrik 2020, Trusti kishte nën menaxhim mbi 2 miliardë euro. Tërheqja eventuale e 10% të kursimeve në secilën llogari, arrin shumën e rreth 200 milionë eurove. Nëse një pjesë e madhe e kësaj shume tërhiqet dhe shpenzohet, atëherë kjo mund ta rriste konsumin e brendshëm duke zhvendosur kurbën e konsumit apo investimit. Për më tepër, mundësia e tërheqjes së kursimeve të Trustit, për një pjesë të qytetarëve mund të lehtësojë barrën e borxhit të shkaktuar nga gjendja ekonomike e pandemisë dhe të rrisë qarkullimin e parasë në treg edhe për personat që nuk përfitojnë nga kjo masë.

Investimet e Trustit pritet të kenë lëkundje të vazhdueshme gjatë muajve të pandemisë duke i bërë kursimet relativisht të pasigurta. Në rast se çmimi për njësi të Trustit bie, atëherë tërheqja e disa mjeteve në këtë kohë do të ishte e levërdishme. Megjithatë, parashikimi i trendit të çmimit të njësisë brenda periudhave të caktuara është pothuajse i pamundshëm.

²⁰ Trusti. Alokimi Strategjik. Burimi: <https://bit.ly/2DGeoul>

²¹ Pasqyra e BQK-së deri në muajin qershor. Burimi: <https://bit.ly/3fNrZlr>

Pasqyra e tremujorit të parë të Trustit për vitin 2020. Burimi: <https://bit.ly/32AcR3N>

²² Ibid.

Dëmet nga tërheqja e hershme e kursimeve pensionale nga Trusti

Tërheqja e parakohshme e të hollave nga Trusti do të reduktonte kursimet e qytetarëve kontributpagues të dedikuara për moshën e pensionimit. Marrë parasysh kthimin mesatar të Trustit në investim, tërheqja e 1 mijë eurove në moshën 40 vjeçare redukton rreth dy mijë euro kthim në interes apo rreth 3 mijë euro në total më pak për periudhën e pensionit. Kurse personat që tërheqin 2 mijë euro humbasin rreth 4 mijë euro interes për 25 vitet e ardhshme.²³

Mundësia e tërheqjes së parakohshme të mjeteve të Trustit nuk do të ishte e dobishme për një numër të madh të qytetarëve të Kosovës. Fillimisht, kjo masë nuk stimulon personat që më së shumti kanë nevojë, si ata të papunë dhe personat e punësuar pa kontrata pune ku të ardhurat e tyre janë relativisht të vogla. Në veçanti, në këtë grup hyn sektori i bujqësisë, ndërtimtarisë dhe ai i gastronomisë, ku informaliteti është më i lartë.²⁴ Po ashtu, bilanci mesatar i të gjitha llogarive në Trust arrin shumën e 3,284 euro, që me masë të re i bie afro 328 euro mundësi të tërheqjes. Kjo shumë do të ishte e levërdishme po të aplikohesh të të gjithë kontributpaguesit, mirëpo në llogaritë individuale ka devijime të mëdha sa i përket kursimeve. Në vitin 2019, rreth 46% e kontributpaguesve ishin të moshës nën 34 vjeçare dhe rrjedhimisht me gjasa të vogla të kenë të kursyer shuma të mëdha për ta bërë të levërdishme tërheqjen e 10%-shit të tyre. Po ashtu, dallime të theksuara ka edhe sa i përket gjinisë, ku rreth 67% të kontributpaguesve janë burra dhe vetëm 33% gra.²⁵ Në vitin 2019, kontributi mujor në Trust për një grua punëmarrëse ishte 40.59 euro ndërsa për një burrë 46.47 euro. Përveç faktit që gratë janë më pak të punësuar dhe kontribojnë më pak në Trust, sipas parashikimit të popullsisë së Kosovës, ato jetojnë në mesatare rreth 3.6 vitë më gjatë se burrat dhe kjo rrezikon që ato të mbesin më gjatë pa pension.²⁶

Përfituesit potencial të kësaj mase mund të jenë kontribuesit e rregullt të moshës 35 deri në 64 vjeç të cilët kanë para të kursyera në Trust. Tërheqja e mjeteve të Trustit si masë e vetme për stimulimin e ekonomisë gjatë pandemisë është e pamjaftueshme. Një numër i qytetarëve nuk kanë kursime të mjaftueshme për ta bërë të levërdishme tërheqjen e tyre ndërsa një pjesë tjetër mund të zgjedhë t'i mbajë ato fonde në Trust për periudhën e pensionit. Prandaj, shuma e tërhequr dhe ndikimi i saj në ekonomi mund të jetë i pamjaftueshëm për situatën ekonomike që pritet ta shkaktojë gjendja e pandemisë.

Tabela 1. Moshë dhe shuma mesatare e kontribuuesve në vitin 2019.

Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
Përqindja	16.7%	29.1%	22.9%	17.9%	12.4%	0.9%
Kontributi mesatar mujor i punëmarrësve	€28.81	€41.00	€51.09	€51.30	€57.02	€64.32

Burimi: Trusti²⁷

²³ Kthimi mesatar 2010-2019 është rreth 4.469 përqind, investimi fillestar 1,000 euro për 25 vjet kur personi 40 vjeç pritet të mbërrijë pensionimin dhe norma e inflacionit rreth 2 përqind. Ky kalkulim supozon normën e njëjtë të kthimit (4.469 %) të Trustit për 25 vjet.

²⁴ Trusti. Raporti vjetor 2019. Burimi: <https://bit.ly/2ZwjUsE>

²⁵ Ibid.

²⁶ Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Parashikimi i Popullsisë së Kosovës 2017-2061. Burimi: <https://bit.ly/3eAmJgk>

²⁷ Trusti. Raporti vjetor 2019. Burimi: <https://bit.ly/2ZwjUsE>

Trusti ka rreth 670 mijë llogari të hapura të kontributpaguesve që nga themelimi ku prej tyre rreth 380 mijë janë llogari aktive.²⁸ Ofrimi i mundësisë së tërheqjes së parakohshme të 10% të kursimeve të secilës llogari kërkon procesim dhe ekzekutim të një numri të madh të pagesave brenda një kohe të shkurtër. Kjo mund ta paraqes nevojën për rritje të stafit të Trustit për të realizuar transferet me kohë. Në takimin e fundit të Bordit Drejtues të Trustit dhe Kryeministrit të Kosovës bordi theksoi nevojën e zgjerimit të kapaciteteve operuese për të zbatuar këtë masë.²⁹

Një numër i qytetarëve nuk janë të informuar rreth platformës online të Trustit që tregon shumën e kursyer të çdo personi të regjistruar dhe/apo shumën që mund ta tërheqin. Përveç kësaj, mjetet e qytetarëve në Trust ndryshojnë në kohë reale dhe si rrjedhojë mund të ketë paqartësi apo diskrepancë në mes të kursimeve në momentin që shikohen online dhe në kohën e tërheqjes së 10% të tyre. Pas propozimit të kësaj mase është shtuar interesimi i qytetarëve për platformën online të Trustit dhe gjatë kësaj kohe janë vërejtur rënie periodike të sistemit online.

Nuk ka bazë ligjore për ofrimin e mundësisë së tërheqjes së parakohshme të 10 përqind të fondeve nga Trusti dhe si rezultat kërkohen ndryshime ligjore. Sipas ligjit të fondeve pensionale të Kosovës dhe rregulloreve të Bankës Qendrore të Kosovës, kursimet pensionale mund të tërhiqen nga kontribuuesit a) kur arrihet mosha e pensionit (65 vjeç); b) kur personi është përfitues i ndihmës së invaliditetit nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; dhe c) në rast të vdekjes para tërheqjes së kursimeve pensionale, me ç'rast trashëgimtarët tërheqin gjithë bilancin e kursyer.³⁰ Mirëpo, me pakon e ligjeve për rimëkëmbjen ekonomike mendohet ndryshimi i ligjit për të mundësuar tërheqjen e parakohshme të 10 përqind të kursimeve pensionale.³¹

Një pjesë e madhe e konsumit të shtuar nga tërheqja e kursimeve të Trustit mund të orientohet drejt produkteve të importuara duke reduktuar multiplikatorin apo qarkullimin e parasë në ekonomi përtej pritshmërive. Po ashtu, marrë parasysh që personat me të ardhura më të larta mund të tërheqin më shumë mjete, një pjesë e tyre mund të mos konsumohet fare por të kursehet në bankë për ndonjë periudhë tjetër dhe rrejdhimisht të dalë prapë jashtë qarkullimit. Një situatë e tillë nuk do të ndikonte në rritjen e konsumit të brendshëm ashtu siç mund të pritet.

Edhe pse tërheqja eventuale e parave të Trustit nga bankat komerciale nuk rrezikon t'i bëj bankat jolikuide, megjithatë, kjo politikë mund të reduktoj likuiditetin bankar. Një rënie e tillë mund të ndikojë në rritjen e normave të interesit në depozita dhe/apo kredi ndonëse kjo është më pak e pritshme marrë parasysh nivelin aktual të likuiditetit bankar edhe pa mjetet e Trustit.

Ofrimi i mundësisë së tërheqjes së 10% të kursimeve në Trust mund të krijojë një praktikë të ndërhyrjes në të holla të Trustit për të lehtësuar gjendjen ekonomike të qytetarëve. Kjo dukuri mund të përsëritet edhe në muajt në vijim kur pritet që efektet ekonomike të pandemisë të vazhdojnë apo në ndonjë krizë ekonomike tjetër në të ardhmen.

²⁸ Ibid.

²⁹ Trusti. Çështja e 10%-shit: FKPK-ja në takim me Kryeministrin e Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3zjadil>

³⁰ Trusti. Raporti vjetor 2019. Burimi: <https://bit.ly/2ZwjUsE>

³¹ Projektligji për Rimëkëmbjen Ekonomike-Covid-19. Burimi: <https://bit.ly/2OlfV6o>

Me tërheqjen e 10% të kursimeve pensionale, qytetarët humbin mundësinë që përmes Trustit, ato fonde t'i investojnë në tregje financiare globale në kohë kur çmimet për njësi janë relativisht të vogla dhe mundësitë e përfitimit në të ardhmen janë më të mëdha. Çmimi për njësi në Trust momentalisht është më i ulët se sa që mund të jetë në një të ardhme kur qytetarët dëshirojnë t'i rikuperojnë investimet. Në atë rast, rikuperimi i kursimeve (njësive) do të kushtojë më shumë se sa mbajtja e kursimeve aktuale sepse çmimi për njësi në Trust do të rritej. Tërheqja e mjeteve nga Trusti në kohë kur investimet e Trustit përballen me rënie të çmimit të njësive nënkupton kapitalizimin e humbjes në investim sepse nuk pritet koha e rikuperimit të rënieve periodike të investimeve.

Informimi i dobët i qytetarëve rreth planifikimit financiar e në veçanti kursimeve pensionale mbi normën e obliguar me ligj, mund t'i gjejë shumë qytetarë në varësi të ndihmës së shtetit gjatë kohës së pensionit. Aktualisht, me bilancin mesatar prej 3,284 eurove të kursyera në Trust, qytetarët mund të marrin nga 200 euro në muaj për vetëm 16 muajt e parë të pensionimit, ndërkaq sipas parashikimit të popullsisë së Kosovës, jetëgjatësia është mesatarisht 77 vjeç.³² Prandaj tërheqja e fondeve në këtë periudhë, redukton fuqinë blerëse të qytetarëve në të ardhmen.

Përfundime

Kriza emergjente shëndetësore e shkaktuar nga pandemia e virusit korona ka prekur direkt ekonominë e pothuajse të gjitha vendeve në botë. Kufizimi i lëvizjes ka shkaktuar rënie të të hyrave nga shumë veprimtari afariste në lloje të ndryshme të industrisë dhe në përgjithësi ulje të kërkesës agregate. Andaj, është e natyrshme që Qeveria e Kosovës të propozojë masa për rimëkëmbje ekonomike që synojnë ngritjen e kërkesës agregate.

Propozimi i lejitimit të tërheqjes së 10 përqind të kursimeve pensionale është një metodë jokonvencionale e arritjes së këtij synimi. Por, sikurse që kemi argumentuar më lartë, kjo masë nuk ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë buxhetin e shtetit apo borxhin publik të Kosovës, përderisa ofron mundësinë që qytetarët të cilët kanë kursime t'i tërheqin ato në mënyrë që ta kalojnë këtë situatë sa më lehtë që është e mundur. Shpenzimet e këtyre qytetarëve mund të rrisin qarkullimin e parasë në treg edhe për personat që nuk kanë përfitojnë drejtpërdrejt nga kjo masë. Për më tepër, nga tërheqja e 10% të kursimeve nga Trusti nuk rrezikohet likuiditeti i sistemit financiar të Kosovës apo likuiditeti i vetë Trustit.

Në anën tjetër, kjo masë e re e stimulimit të ekonomisë nuk garanton rritjen e parashikuar të kërkesës agregate. Fillimisht, nga mundësia e tërheqjes së kursimeve pensionale ose nuk përfitojnë fare personat që kanë më së shumti nevojë për para të gatshme sikurse personat e papapunë, apo përfitojnë shumë pak sikurse personat me paga relativisht të vogla të cilët nuk kanë mjaftueshëm para të kursyera për ta bërë të levërdishme tërheqjen e kursimeve. Përfundimisht, shumica e përgjithshme që mund të tërhiqet me këtë masë është më pak se 200 milionë euro, duke bërë që ndikimi në kërkesë agregate të jetë jo i madh.

³² Ibid., dhe Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Statistikat e përgjithshme. Burimi: <https://bit.ly/3jpC7zH>




Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Projekti “Inovacioni për mediat e qëndrueshme dhe angazhimin qytetar” implementohet nga:

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



KOSOVO 2.0





European
Union
Kosovo

KOSOVO 2.0

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

Dilema 10%
përfitimet dhe dëmet nga
tërheqja e parakohshme e
kursimeve pensionale